



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 59

Prishtinë, më 1 tetor 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi- kryetar i Komisionit, Arsim Bajrami, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Halit Krasniqi, Albulena Haxhiu, Amir Ahmeti dhe Jasmina Zhivković.

Munguan: Behar Selimi, Mufera Şinik dhe Haki Demolli.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Liridon Dobërdolani – NDI, Besarta Zuka – NDI, Lejla Selimi – OSBE, Rebeka Maliqi, Fahrije Bajrami, Visar Smajlaj, Agron Vrenezi – OHCHR, Lumnije Murati – ZPRK, Arben Shamolli – ISKP dhe Shkëlzen Gerxhaliu – praktikant.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 6 dhe 19.09.2012;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin Nr. 04/L-87 për parkun kombëtar “Sharri”;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin Nr. 04/L-86 për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”;
5. Shqyrtimi i propozimeve për emërimin e anëtarëve të Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudence;
6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale;
7. Shqyrtimi i kërkesës së Kuvendit Komunal të Klinës;
8. Formimi i grupit punues në Projektligjin për provimin e jurisprudence;
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Albulena Haxhiu – Kishte vërejtje në pikën 5, pasi ajo nuk kishte pranuar ndonjë material rreth propozimeve për anëtarët e Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës. Vërejtje, po ashtu, kishte edhe në pikën 8, pasi vlerësoi se ende nuk dihet nëse projektligji do të kalojë në seancë, prandaj nuk duhet të paragjykohej. Si rrjedhojë ajo kërkoi që të dy këto pika të rendit të ditës të shtyhen, ndërsa për pikën 6 kërkoi më tepër kohë për shkak se projektligji është mjaft voluminoz dhe nuk ka pasur kohë të mjaftueshme që të shqyrtohet i tëri.

Kryetari – Sqaroi se materiali nuk është shpërndarë qëllimisht pasi ne duhet të vendosim në parim, si Komision, që ose të procedojmë emrat e anëtarëve për formimin e tij për dhënien e provimit të jurisprudencës, ose të presim ligjin e ri. Ligji aktual dhe ligji i cili është në procedurë kanë dallim pikërisht në mënyrën e formimit të anëtarëve të Komisionit. Sa i përket shqyrtimit të projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale tha se kërkesa është e arsyeshme, pasi ligji është voluminoz. Mirëpo, i mbetet Komisionit të marrë një vendim.

Armend Zemaj – Sa i përket pikës së pestë ai tha se është dashur të shpërndahen emrat për faktin se të gjithë ata që i nënshtrohen provimit, pavarësisht procedurës ligjore, duhet ta kenë qasjen sipas ligjit aktual. Çështje tjetër është nëse Kuvendi vendos se kandidatet i plotësojnë ose jo kushtet sipas ligjit në fuqi. Ai tha se nuk mund të lihen në pritje të gjithë ata të cilët janë të interesuar ta kalojnë këtë provim nëse Komisioni i plotëson kriteret ligjore. Çështja tjetër është se pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri mund të kemi një amendament që e përcakton mandatin e tyre, por e rëndësishme është që të gjithë ata të cilët janë të përgatitur ta japin këtë provim të mos neglizhohen si rezultat i procedurave. Sa i përket formimit të grupit punues ai shtoi se duhet ta presin mendimin në seancë plenare, dhe nëse nuk përmirësohen mangësitë të cilat janë evidentuar dhe diskutuar atëherë nuk do ta kenë votën e tij dhe të partisë së tij, pavarësisht se është cekur që ligji është më i avancuar, por gjithsesi duhet të eliminohen disa defekte, siç janë çështja e sistemit 3 dhe 4 vjeçar dhe çështja e doktoratës.

Amir Ahmeti – Sa i përket pikës 5 pohoi se edhe nëse ligji shkon në rrjedha normale, prapë ky ligj nuk mund të hyjë në fuqi brenda këtij viti si rezultat i çështjeve procedurale. Prandaj duhet të procedojmë propozimet për anëtarë të Komisionit, sipas ligjit të vjetër, në mënyrë që t'u mundësohet kandidateve të interesuar nënshtimi në provim.

Kryetari – Kemi propozimet që pika 5, shqyrtimi i propozimeve për emërimin e anëtarëve të Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës, të shtyhet për mbledhjen e radhës dhe materialet t'u shpërndahet anëtarëve të Komisionit. Pika 6, shqyrtimi në parim i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, kërkesa e Albulena Haxhiut ishte të shtyhet, dhe pika 8, formimi i grupit punues në Projektligjin për provimin e jurisprudencës, po ashtu, ishte të hiqet nga rendi i ditës.

Rendi ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 6 dhe 19.09.2012

Albulena Haxhiu – Kishte vërejtje në procesverbalin e datës 19.09.2012, në pikën 5, ku u shqyrtua në parim projektligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale, pikë në të cilën ajo kishte shfaqur qëndrimet e saj dhe të subjektit të cilin e përfaqëson. Ajo ishte kundër procedimit të Projektligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale në seancë plenare për shqyrtim dhe miratim.

Armend Zemaj – Tha se në diskutimin ku është shqyrtuar raporti i KQZ- së, ai nuk i është adresuar punës së zyrtarit në fjalë, pra kryeshefit ekzekutiv, por i është adresuar punës së kryetares së KQZ-së, dhe këtij institucioni në përgjithësi. Kurse te shqyrtimi në parim i projektligjit për provimin e jurisprudencës, aty ku është shkruar se “kompetenca e Komisionit për provimin e jurisprudencës është keqpërdorur disa herë nga profesorë të caktuar”, tha se nuk janë përmendur profesorët, por kritika u është adresuar individëve të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë, të cilët edhe neglizhojnë reformimin e këtij sistemi.

Amir Ahmeti- Kishte vërejtje në procesverbalin e datës 19.09.2012, te formimi i grupit punues në PL për procedurën përmbartimore në të cilin nuk është përfshirë emri im, pjesë e të cilit jam edhe unë.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e datës 06.09.2012, pa vërejtje, kurse procesverbalin e datës 19.09.2012, me vërejtjen e Albulena Haxhiut, Armend Zemjat dhe Amir Ahmetit.*

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin Nr. 04/L-87 për parkun kombëtar “Sharri”

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin Nr. 04/L-87 për parkun kombëtar “Sharri” dhe nuk kishte vërejtje nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji Nr. 04/L-87 për parkun Kombëtar “Sharri”, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin Nr. 04/L-86 për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”

Kryetari – Duke ju referuar amendamentit 5, i cili përcakton se ku do të ndërtohet zyra e parkut, si dhe nga cila drejtori do të menaxhohet dhe kur do të hyjë në fuqi ligji, vërehet mospërputhje me deklaratën e bërë nga Ministria e Financave, të cilët kanë thënë se nuk kanë buxhet të mjaftueshëm dhe ligji nuk mund të hyjë në fuqi para vitit 2014, kurse neni i 6-të i cili thotë se e drejta pronësore dhe denacionalizimi rregullohen me ligj të veçantë dhe nuk janë subjekt i këtij ligji, e vlerësoi si një formë e mirë e decentralizimit për faktin se e afron drejtorinë me qytetarin dhe modeli është marrë edhe nga vendet perëndimore.

Armend Zemaj – Tha se amendamenti 5, neni 4, ku bëhet fjalë për krijimin e drejtorisë për administrimin e parkut kombëtar mund të shkaktoj një konfuzion ose përzierje kompetencash mes drejtorisë e cila është përcaktuar nga Ministria për Planifikim Hapësinor dhe zyrës që tashmë është përcaktuar me seli në Pejë. Neni 5, në mënyrë estetike është diçka i mirë, por diçka që nuk haset në Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet e deritanishme, sepse e njëjta çështje është edhe me dy projektligjet e tjera, por nuk theksohet në këtë formë. Pastaj, nëse për njërin park ka një seli, si do të jetë për parkun tjetër? Kështu ne do të kemi vetëm themelim të selive dhe ngarkim buxhetit dhe një menaxhim ndoshta jo të mirë të asaj hapësire nacionale ose publike.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji Nr. 04/L-86 për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i kërkesës së Kuvendit Komunal të Klinës

Kryetari i njoftoi me kërkesën e Kuvendit Komunal të Klinës lidhur me sqarimin dhe interpretimin e ligjit për shitjen e banesave, për të cilat ekziston e drejta banesore Nr. 04/L-061. Me këtë shkresë Kuvendi Komunal i Klinës ka sqaruar se Komuna e Klinës ka bërë ndërtimin e disa objekteve afariste –

banesore përmes koncesioneve pas vitit 1999, ku ka përfituar një numër të banesave dhe lokaleve afariste në pronësi të saj. Këto banesa i janë dhënë në shfrytëzim disa zyrtarëve komunalë me të drejtë shfrytëzimi për periudhën 10- vjeçare. Në këtë kontest Kuvendi komunal i Klinës ka kërkuar sqarim se a ka të drejtë Komuna të bëjë shitjen e këtyre banesave në pajtim me ligjin Nr. 04/L-061. Propozoi që shkresa t'i procedohet Komisionit FunkSIONal për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Ardian Gjini- Tha se Kuvendi i Kosoves nuk është institucion që interpreton ligjin por institucion i cili nxjerr ligjet. Vlerësoi se duhet t'i kthehet një përgjigje e saktë Kuvendi Komunal, sepse ata duhet të kenë avokatin i cili duhet ta konsultojë dhe ta interpretojë ligjin.

Armend Zemaj-Tha se edhe pse ky ligj nuk është në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion, nëse pajtoheni që ne t'ia bëjmë një interpretim këtij ligji në bashkëpunim me kryetarin e Komisionit. Edhe pse, nëse e shikojmë me vëmendje, këto banesa të shfrytëzuara për 10 vjet nga disa zyrtarë dhe tash këta zyrtarë kanë arritur të sigurojnë mjetet për t'i blerë këto banesa, kjo është një trajtim tjetër ligjor që mund ta bëjë edhe Agjencia Kundër Korrupsion. Ai tha se duhet të shikohet baza ligjore se me çfarë vendimi janë ndërtuar këto objekte, çka parashihet në atë vendim, sepse shkresa si e tillë është e mangët. Në fund tha se duhet të kemi kujdes të mos krijojmë precedent që edhe nëpër komuna të tjera individ të caktuar të përfitojnë me pronën publike.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Komisioni për Legjislacion konstatoi se kjo çështje nuk bie në fushëveprimin e tij dhe i procedohet Komisionit FunkSIONal për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me vlerësimin se ligji për shitjen e banesave, për të cilat ekziston e drejta banesore Nr. 04/L-061 e ka qartësinë e duhur normative. Prandaj është e nevojshme që Komisioni FunkSIONal të veprojë në pajtim me këtë ligj.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

Kryetari i Komisionit

E përgatiti:

Arben Gashi

Stafi Mbështetës i Komisionit.